

Vendim nr. 218 datë 31.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 31.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (Sh) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQATA “ALBANIAN RENEWABLE ENERGY ASSOCIATION” (AREA), përfaqësuar nga drejtore ekzekutive Marsida Nuredini dhe avokate Merita Lazimi (Tabaku), me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 12 (86-2024-151), datë 13.02.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2025-703 (2), datë 13.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Karta Evropiane e Gjyqtarit; Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është organizatë jofitimprurëse, në formën e shoqatës, në të cilën janë anëtarësuar 72 subjekte që operojnë në fushën e prodhimit të energjisë elektrike si prodhues me përparësi të saj. Sipas statutit të shoqatës, ajo përfaqëson interesat e sektorit të energjisë së rinovueshme, përfshirë profesionistët, kompanitë dhe subjekte të tjera që veprojnë në fushën e energjisë së rinovueshme në Shqipëri (neni 4, pika 2).

2. Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 398, datë 09.06.2022 “Për trajtimin e disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike” (VKM nr. 398/2022), i cili ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 13.06.2022. Në këtë VKM është përcaktuar mënyra e trajtimit të disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe kostot përkatëse për mbulimin e tyre. Nga rrethanat rezulton se kërkuesja është përfshirë në fazën e diskutimeve para miratimit të kësaj VKM-je dhe në vijim ka pasur disa takime dhe kontakte me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (*shoqëria “FTL” sh.a.*), e cila është e ngarkuar për kryerjen e detyrave të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme deri në fillimin e veprimtarisë funksionale të tij, dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për sa u përket pretendimeve të saj (kërkueses) për efektet prapavepruese të aktit normativ, si dhe për tarifën e shërbimit të balancimit.

3. Shoqëria “FTL” sh.a., me shkresën nr. 1732/1 prot., datë 04.08.2022, i ka kthyer përgjigje kërkueses se VKM-ja dhe rregullat e tregut shqiptar të balancimit janë të detyrueshme për t’u zbatuar pa përjashtim nga të gjithë prodhuesit me përparësi dhe pavarësisht vullnetit të palëve, të gjithë prodhuesit që kanë kontratë shitblerjeje energjie elektrike konsiderohen pjesë e grupit të balancimit të shoqërisë “FTL” sh.a. që nga data 1 prill 2021, si dhe tarifa për shërbimin e balancimit për vitin 2021 është 0.0198 lekë/kwh dhe për vitin 2022 është 0.0199 lekë/kwh.

4. Në këto kushte kërkesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e VKM-së nr. 398/2022, me palë të paditur Këshillin e Ministrave dhe persona të tretë MIE-n dhe shoqërinë “FTL” sh.a., me pretendimin se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.12 (86-2024-151), datë 13.02.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se ajo është e pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkesja.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-703 (2), datë 13.01.2025, në seancë plenare, me praninë e palëve, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se ky vendim, referuar përmbajtjes dhe linjës arsyetuese të tij, është në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material dhe në përputhje edhe me praktikën gjyqësore të konsoliduar të atij kolegji.

6. Në datën 27.05.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kriterëve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 11.06.2025.

II

Pretendimet e kërkeses

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe pretendimet e kërkeses. Të dyja gjykatat kanë kryer vetëm formalisht një proces gjyqësor, pasi nuk kanë arsyetuar nëse kishte shkelje të rënda procedurale. Ato duhet të konstatojnë paligjshmërinë e aktit, pasi ai nuk ofron kritere objektive, transparente, të përcaktuara dhe të barabarta për sa u përket elementeve që mbahen parasysh për një eficiencë sa më të lartë në punën e prodhuesve të energjisë elektrike. Në rekurs janë ngritur çështje ligji, të cilat Gjykata e Lartë nuk i ka mbajtur në konsideratë, veçanërisht fakti se gjykata e apelit ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Po kështu, çështja ka në objekt përputhshmërinë e aktit normativ me interesin publik dhe interesat e anëtarëve të shoqatës, të cilët kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore afatgjata me shtetin shqiptar. Në këtë kuptim, është detyrë e Gjykatës së Lartë t’u kthejë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese. Kërkesja ka pretenduar verifikimin nga gjykatat nëse VKM-ja është miratuar nga nevoja, domosdoshmëria dhe përshtatshmëria, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë prej

tyre. Mosmarrja në shqyrtim e këtyre pretendimeve ka cenuar edhe *parimin e sigurisë juridike*, si element i parimit të shtetit të së drejtës.

III Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuësja ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në një proces të vënë në lëvizje prej saj për kundërshtimin e VKM-së nr. 398/2022. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të saj, duke iu referuar paligjshmërisë së aktit. Në këtë kuptim, Kolegji çmon ta analizojë legjitimimin e kërkueses sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, kërkuësja legjitimohet, pasi ka qenë palë paditëse në procesin gjyqësor, përmes të cilit ka kundërshtuar VKM-në nr. 398/2022, për rrjedhojë provon interesin e saj të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin e datës 13.01.2025 të Gjykatës së Lartë, i cili i është komunikuar kërkueses nëpërmjet postës elektronike në datën 27.02.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Lidhur me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit dhe parimit të sigurisë juridike. Për sa i përket këtij të fundit, kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë argument konkret kushtetues, por e ka lidhur atë me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe pretendimet e saj, ndërsa të dyja gjykatat kanë kryer vetëm formalisht një proces gjyqësor, pasi nuk kanë arsyetuar nëse kishte shkelje të rënda procedurale. Sipas saj, gjykatat duhet të konstatonin paligjshmërinë e aktit, pasi ai nuk ofron kriterë objektive, transparente, të përcaktuara dhe të barabarta për sa u përket elementeve që mbahen parasysh për një efikasitet sa më të lartë në punën e prodhuesve të energjisë elektrike. Kërkuësja ka pretenduar gjithashtu se në rekurs janë ngritur çështje që i përkasin Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, të cilat nuk janë mbajtur në konsideratë nga kjo gjykatë, veçanërisht fakti se gjykata e apelit ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Po kështu, sipas kërkueses, çështja ka në objekt përputhshmërinë e aktit normativ me interesin publik dhe interesat e anëtarëve të shoqatës, të cilët kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore afatgjata me shtetin shqiptar dhe është detyrë e Gjykatës së Lartë t’u kthejë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese. Kërkuësja ka pretenduar verifikimin nga gjykatat nëse VKM-ja është miratuar nga nevoja, domosdoshmëria dhe përshtatshmëria, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë prej tyre.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre

dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa i takon standardit të arsytimit të vendimit, Gjykata ka pohuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij vendimi gjyqësor duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr.12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata në vijimësi është shprehur se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në këto standarde, në vijim, Kolegji do të analizojë nëse gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë marrë në shqyrtim dhe u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuases për paligjshmërinë e VKM-së nr. 398/2022 dhe nëse arsyetimi i tyre ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

18. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit për kundërshtimin e aktit normativ, me pretendimin se VKM-ja nr. 398/2022 ka prekur interesat e të gjithë prodhuesve të energjisë, duke i ngarkuar ata me përgjegjësi kolektive; ajo vjen në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës, pasi ndonëse ligji ka autorizuar nxjerrjen e saj, ai nuk ka përcaktuar parimet në të cilat duhet të mbështetet akti (transparencën, informimin, proporcionalitetin dhe mosdiskriminimin); ajo zbatohet me fuqi prapavepruese, pasi parashikon se prodhuesit me përparësi nga data 01.04.2021 janë automatikisht pjesë e grupit të balancimit të operatorit të energjisë së rinovueshme, pra pagesa e disbalancës është kërkuar nga kjo datë; pikat 1 dhe 2 të kreut III të VKM-së nr. 398/2022 bien në kundërshtim me dispozitat e ligjeve nr. 7/2017, datë 02.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (*ligji nr. 7/2017*)

dhe nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” (ligji nr. 43/2015); VKM-ja është miratuar tej afatit 12-mujor të parashikuar nga ligji nr. 43/2015, konkretisht pas 7 vjetësh dhe tarifa e shërbimit është miratuar në tejkalim të kompetencave të Këshillit të Ministrave.

19. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se, *së pari*, VKM-ja nuk vjen në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës, përderisa nisma e MIE-it për nxjerrjen e këtij akti dhe miratimi i tij nga Këshilli i Ministrave janë të mbështetura në pikën 4 të nenit 99 të ligjit nr. 43/2015, ku parashikohet shprehimisht ky delegim. *Së dyti*, nuk janë cenuar parimet e përgjithshme të së drejtës administrative (ligjshmëria, transparenca, informimi, këshillimi dhe mosdiskriminimi), pasi kërkesja ka paraqitur qëndrimin e saj për nismën dhe përmbajtjen e aktit nënligjor dhe nuk konstatohen elemente që passjellin trajtim ndryshe për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike. *Së treti*, në lidhje me pretendimin se akti nënligjor është nxjerrë në tejkalim të afatit 12-mujor të parashikuar nga ligji, gjykata e apelit ka arsyetuar se ky fakt nuk përbën në vetvete motiv për të vlerësuar të paligjshëm aktin dhe nuk ka asnjë rrethanë tjetër specifike që kërkon miratimin e tij në afatin e përcaktuar nga ligji. *Së katërti*, për sa i përket pretendimit të efektit prapaveprues të VKM-së nr. 398/2022, kjo gjykatë ka vlerësuar se ky akt ka parashikuar shprehimisht se prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike nga data 01.04.2021 janë automatikisht pjesë e grupit të balancimit të operatorit të energjisë së rinovueshme. Sipas vendimit nr.106, datë 02.07.2020 (vendim nr. 106/2020) të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) është krijuar tregu shqiptar i balancimit të energjisë elektrike dhe nga data 01.04.2021 lind përgjegjësia për të gjithë prodhuesit ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për të marrë pjesë dhe për të pasur përgjegjësi për kostot e disbalancave të shkaktuara. Kjo përgjegjësi buron edhe nga ligji nr. 7/2017, sipas të cilit prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë përgjegjës për disbalancat e tyre. Në zbatim të këtij ligji Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) ka lëshuar faturat përkatëse drejtuar shoqërisë “FTL” sh.a., duke përfshirë disbalancat e shkaktuara nga të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, pavarësisht pjesëmarrjes ose jo në grupin e balancimit të kësaj të fundit. Kjo rrethanë bazohet në faktin që këto detyrime nuk mund të shpërndareshin, pasi Këshilli i Ministrave ende nuk kishte miratuar aktin nënligjor mbi bazën e të cilit do të përcaktohej mënyra e trajtimit të disbalancave dhe kostot përkatëse që nga koha e krijimit të tregut të balancimit në datën 01.04.2021. Në këtë kuptim, sipas gjykatës, parashikimet ligjore përmbushin kriteret e vlerësimit të ligjshmërisë të nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, sepse nuk janë në kundërshtim me ligjin, janë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, janë bërë

vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe janë në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar nxjerrjen e tyre, pra respektojnë edhe parimin e proporcionalitetit. Po kështu, kjo gjykatë ka vlerësuar se për sa i përket mbajtjes së përgjegjësisë për disbalancat, afati maksimal i përcaktuar nga ligjvënësi për përjashtimin nga kostot e disbalancave ka qenë deri në krijimin e tregut të balancimit, pra data 01.04.2021. Në përfundim gjykata e apelit ka vlerësuar se VKM-ja respekton parimin e proporcionalitetit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesja.

20. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Fillimisht, ai ka vlerësuar se akti objekt gjykimi ka natyrë normative dhe se kërkuesja legjitimohet për paraqitjen e padisë referuar interesave që kërkon të mbrojë nëpërmjet saj. Për sa i përket themelit të çështjes, ky kolegji ka vlerësuar të drejtë arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit për sa i përket pretendimit të kërkueses se akti nënligjor është në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës. Sipas kolegjit, nga pikëpamja formale, akti nënligjor normativ i kundërshtuar është nxjerrë konform kushteve që përcakton kjo dispozitë kushtetuese, përderisa ai është nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit nga një organ i parashikuar në Kushtetutë dhe i autorizuar posaçërisht nga ligji. Në nismën për përgatitjen dhe bashkërendimin e punës nga MIE-i, si edhe në procedurën dhe vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave janë respektuar parimet e përgjithshme të ligjshmërisë, transparencës, informimit, këshillimit, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, pasi kërkuesja ka qenë e përfshirë në procesin paraprak të përgatitjes së kësaj nisme nënligjore dhe fakti se qëndrimet e saj nuk janë të reflektuara plotësisht në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Ministrave nuk nënkupton cenimin e të drejtave dhe parimeve për transparencë, informim dhe këshillim; nuk ka trajtim ndryshe me natyrë diskriminuese të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike; ndonëse akti nënligjor është miratuar në tejkalim të afatit 12-mujor të parashikuar nga ligji, kjo nuk përbën në vetvete shkak për të vlerësuar të paligjshëm aktin normativ, nëse nuk ka ndonjë rrethanë tjetër specifike e konkrete që passjell paligjshmërinë.

21. Edhe për sa i përket pretendimit për zbatimin me efekt prapaveprues të VKM-së nr. 398/2022, Gjykata e Lartë ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së apelit. Sipas saj, vetë VKM-ja ka parashikuar se të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, nga data 01.4.2021, janë automatikisht pjesë e grupit të balancimit të operatorit të energjisë së rinovueshme. Bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi, kuadri rregullator në lidhje me tregun e balancimit të energjisë elektrike është miratuar me vendimin e ERE-s nr. 106/2020, bazuar në dispozitën e nenit

100 të ligjit nr. 43/2015. Sipas këtij vendimi, ky treg balancimi vepron bazuar mbi këto rregulla nga data 01.04.2021. Për më tepër, vendimi i ERE-s është kundërshtuar në gjykatë dhe gjykimi është pushuar për arsye se pala paditëse ka hequr dorë nga gjykimi, pra ai prezumohet i ligjshëm derisa një gjykatë kompetente nuk ka vlerësuar për paligjshmërinë e tij. Gjykata e Lartë ka vlerësuar gjithashtu se vetë krijimi i tregut në datën 01.04.2021 vendoste vetvetiu lindjen e përgjegjësi për të gjithë prodhuesit ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për të marrë pjesë dhe për të pasur përgjegjësi në lidhje me kostot e disbalancave të shkaktuara, përgjegjësi e cila buronte nga ligji nr. 7/2017. Po kështu, parashikimet e VKM-së përmbushnin kriteret e vlerësimit të ligjshmërisë të nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk janë në kundërshtim me ligjin, janë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, janë bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe janë në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar nxjerrjen e tyre, duke respektuar edhe parimin e proporcionalitetit. Balancimi i sistemit elektroenergjetik sipas kësaj gjykate është një proces i nevojshëm për të garantuar një operim të sigurt dhe të qëndrueshëm të këtij sistemi, që paraqet edhe një interes të posaçëm publik. Operatorët e rrjetit, përkatësisht OST sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), janë përgjegjës për operimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemeve. Krahas tyre, me qëllim garantimin e operimit të sigurt të rrjeteve që administrojnë, por edhe për të ndarë financiarisht në mënyrë të drejtë kostot e balancimit të pjesëmarrësit të tregut, kërkohet zbatimi i pikës 2 të nenit 99 të ligjit nr. 43/2015 për marrjen e përgjegjësisë direkte për balancimin ose duke depozituar kontratën për transferimin e kësaj përgjegjësie ndaj një pale tjetër nga prodhuesit e energjisë elektrike. Pra, sipas ligjit nr. 43/2015, neni 53 etj., përgjegjësia e balancimit, është një detyrim i pjesëmarrësve të tregut, duke qenë përgjegjës financiarisht për sistemimin e disbalancave të krijuara.

22. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesja nuk ka paraqitur argumente bindëse për të mbështetur pretendimin se akti nënligjor ka cenuar në mënyrë thelbësore veprimtarinë e këtyre grup prodhuesve me përparësi të prodhimit të energjisë elektrike. Sipas saj, në rekurs nuk ngrihet dhe as argumentohet, në kuptim të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, ndonjë shkelje konkrete nga Gjykata Administrative e Apelit, por parashtrohen të njëjtat shkaqe të ngritura edhe në padi dhe për të cilat kërkuesja ka marrë përgjigje nga ajo gjykatë.

23. Kolegji vëren se për sa i përket kuadrit ligjor të zbatueshëm në rastin konkret, neni 99, pika 4, i ligjit nr. 43/2015 ka parashikuar se: *“4. Mënyra e trajtimit të disbalancave, të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe kostot përkatëse për mbulimin*

e tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Në zbatim të këtij parashikimi, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 398/2022 në datën 09.06.2022, e cila është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 13.06.2022. Ndërsa pika 2 e kreut III të VKM-së nr. 398/2022 ka parashikuar: *“Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të cilët kanë kontratë shitblerje energjie elektrike me shoqërinë e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë nga burimet e rinovueshme, nga data 1 prill 2021 janë automatikisht pjesë e Grupit të Balancimit të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER)”*. Po kështu, Kolegji evidenton se referuar nenit 3, pika 58, të ligjit nr. 43/2015 “Përgjegjësia e balancimit” është një detyrim i pjesëmarrësve të tregut për balancimin e prodhimit, konsumit, proceseve të shitblerjes të energjisë elektrike, në përputhje me programin e pranuar, duke qenë përgjegjës financiarisht kundrejt OST-së për sistemimin e disbalancave të krijuara. Ndërsa referuar nenit 99, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike (pika 1); pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin nëpërmjet një kontrate me OST-në, duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut (pika 2) dhe OST-ja është përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut (pika 4). Ndërsa sipas nenit 100 të këtij ligji deri në krijimin e tregut të balancimit, tarifat për realizimin e shërbimit të balancimit vendosen sipas metodologjisë së miratuar nga ERE, e cila duhet të reflektojë kostot dhe bëhet publike (pika 3).

24. Ndërsa sipas nenit 8, pika 4, të ligjit nr. 7/2017 (ligji i kohës) prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë përgjegjës për balancimin. Prodhuesit bëhen palë përgjegjëse për balancimin, duke nënshkruar një kontratë me OST sh.a. ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit te një palë tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut dhe procedurat përkatëse të miratuara nga ERE-ja, në konsultim me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu, Kolegji vëren se neni 22, pika 5, i këtij ligji ka parashikuar se deri në krijimin e tregut të balancimit, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2022, prodhuesit ekzistues me përparësi nuk do të jenë përgjegjës për kostot e disbalancave të shkaktuara. Këto kosto do të merren në konsideratë nga ERE në tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike. Prodhuesit ekzistues me përparësi do të njoftojnë skedulën e

prodhimit tek OSSH-ja, në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike. Me vendimin nr. 106/2020, datë 02.07.2020 bordi i ERE-s ka miratuar rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, të cilat kanë hyrë në fuqi pas botimit dhe janë zbatuar nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike pa efekte financiare deri në datën 31.12.2020.

25. Në përmbledhje të parashikimeve ligjore të zbatueshme për rastin konkret, Kolegji vëren se ligji nr. 43/2015 ka përcaktuar përgjegjësinë e prodhuesve të energjisë për disbalancat, ndërsa ligji nr. 7/2017 ka përcaktuar se kjo kategori nuk ka përgjegjësi deri në krijimin e tregut të balancimit. Ky treg është krijuar nga ERE me vendimin e datës 02.07.2020, i cili ka përcaktuar se prodhuesit e energjisë nuk do të kenë përgjegjësi deri në datën 31.12.2020. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, si dhe përmbajtja e pikës 2 të dispozitave kalimtare të VKM-së nr. 398/2022, Kolegji vëren se anëtarët e shoqatës kanë nënshkruar një marrëveshje (aneksi i VKM-së nr. 398/2022) në të cilën pranojnë se janë pjesë e grupit të balancimit. Referuar përmbajtjes së marrëveshjes, pjesëmarrësit e grupit të balancimit nuk kanë asnjë pretendim të tanishëm ose të ardhshëm lidhur me mbajtjen e vlerave respektive të disbalancave mujore, përfshirë mbajtjen e detyrimeve të prapambetura të disbalancave (neni 3, pika 3.5.). Po kështu, nga marrëveshja rezulton se bordi i ERE-s, me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, ka miratuar “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 01.04.2021.

26. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji evidenton se Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke arritur në përfundimin se ai është i pabazuar, pasi anëtarët e shoqatës kanë pasur dijeni se efektet financiare të VKM-së do të fillonin në momentin e krijimit të tregut të disbalancave dhe lidhjes së marrëveshjes me OST sh.a. Kolegji çmon se ndonëse VKM-ja në dukje ka fuqi prapavepruese për sa u përket detyrimeve financiare të anëtarëve të shoqatës në lidhje me disbalancat për sa u përket anëtarëve të shoqatës kërkuese, kjo ka të bëjë vetëm me momentin kohor të vjeljes së detyrimeve, por jo me faktin e ngarkimit të tyre me detyrime edhe për një periudhë që nuk kanë pasur të tilla. Përkundrazi, detyrimet kanë lindur nga ligji dhe anëtarët e shoqatës kërkuese kanë qenë në dijeni të tyre që në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes dhe pranimit të kushteve të saj edhe për sa u përket detyrimeve. Në këtë kuptim, vendimet gjyqësore të kundërshtuara plotësojnë të gjitha elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin dhe nuk konstatohet që interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar

në nivelin që të mund të konsiderohet se kërkueses i janë cenuar të drejtat kushtetuese të pretenduara. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.